



Asociacioni i Komunave të Kosovës

R A P O R T

nga

Takimi i Kolegjjimit për Kryesuesit e Kuvendeve Komunale

Kaçanik, 6 korrik 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjjimit për Kryesuesit e Kuvendeve Komunal



HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut të Kryesuesve të Kuvendeve Komunale, organizoi takimin e radhës të këtij Kolegjiut me 6 korrik 2011 (e mërkurë) me fillim nga ora 11:00 në Restorantin „Parku” në Kaçanik.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

- Ndryshimi i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale,
- Identifikimi i rregulloreve komunale, dhe shkëmbimi i tyre,

Në këtë takim morën pjesë Kryesues të Kuvendeve nga Komunitet e Kosovës, si dhe përfaqësues të AKK. Takimi u kryesua nga Kryesuesi i Kolegjiut për Kryesues të Kuvendeve Komunale z. Xhelal Gashi.

PËRMBLEDHJE

Kryesuesi në hapjen e takimit njoftoi të pranishmit rreth takimit që Kryesuesit kanë pasur me zyrtarët e MAPL për ndryshimin e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe shprehu edhe një herë brengën e tij rreth pjesëmarrjes së dobët të anëtarëve në këtë takim si dhe në takimet e Kolegjiut.

Me këtë rast u cek se Kryesuesit e Kuvendeve Komunale do të duhet të sqarojnë se cilat janë arsyet për këto mungesa të cilat mund të paraqesin pengesë për mbarëvajtjen e punës së Kolegjiut në të ardhmen. Nga pjesëmarrësit u shtua se duhet të ketë një trysni më të madhe për prezencë më aktive si dhe një angazhim më serioz të Kryesuesve në takimet e Kolegjiut, dhe AKK të dërgojë një shkresë tek të gjithë Kryesuesit e Kuvendeve për të kërkuar angazhimin tyre në punët e Kolegjiut.

Gjatë takimit u diskutua dhe u dhanë komente të reja për ndryshim të LVL-së, dhe që këto kërkesa të procedohen edhe për zyrtarët e MAPL-së. Zyrtarëve të AKK-së u mbetet të shënojnë vërejtjet dhe komentet dhe ti parashtrojnë këto kërkesa përmes kanaleve zyrtare MAPL-së.

Më poshtë janë komentet në draft LVL që dolën nga takimi i Kryesuesve të Kuvendeve Komunale.

Komentet e Kolegjiut të Kryesuesve të Kuvendeve Komunale

në projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale

Kolegjiut i Kryesuesve të Kuvendeve Komunale është takuar me datën 06 korrik 2011 dhe ka shqyrtuar draft Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të përpiluar nga MAPL. Si rezultat Kolegjiut propozon ndryshimet dhe plotësimet e draft Ligjit si në vijim:

Neni 1 – Përkufizimet

Propozim: 'Statuti i Komunës' nënkupton aktin kryesor nënligjor që miratohet nga **Kuvendi Komunal** në pajtim me këtë ligj, dhe rregullon organizimin e brendshëm të komunës;

- **Fjala 'anëtarë' apo 'këshilltarë' të ndryshohet me fjalën 'delegat', për arsye se Kuvendi nuk është institucion i cili funksionon në bazë të anëtarësisë dhe nuk është këshillëdhënës. Meqë Kuvendi Komunal është institucion vendimmarrës dhe përfaqësues i popullit, të zgjedhurit e popullit duhet të emërohen me fjalën 'delegatë'.**
- **Fjala 'Kryesues i Kuvendit Komunal' të ndryshohet me fjalën 'Kryetar i Kuvendit Komunal'.**
- **Fjala 'Zëvendëskryesues i Kuvendit Komunal' të ndryshohet me fjalën 'Zëvendëskryetar i Kuvendit Komunal'.**

Neni 6

Propozim: të shtohet teksti në vijim:

- **Mandati i Zëvendëskryetarit të Kuvendit Komunal është i njëjtë me mandatin e Kryetarit të Kuvendit Komunal.**
- **Me kërkesë të Kryetarit të Kuvendit Komunal, Zëvendëskryetari i Kuvendit Komunal ndihmon Kryetarin e Kuvendit Komunal në ushtrimin e funksioneve të përditshme të Kuvendit dhe vepron në emër të Kryetarit të Kuvendit Komunal në mungesë të tij.**
- **Zëvendëskryetari i Kuvendit Komunal mund të ushtroj detyrat dhe përgjegjësitë me rastin e mungesës së Kryetarit të Kuvendit Komunal, në një periudhë jo më gjatë se 45 ditë.**

Neni 8 – Votimi dhe zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit Komunal

Pika 4: Nëse edhe pas votimit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar si në pikën 3 të këtij Udhëzimi atëherë shkohet në votimin e tretë. Në votimin e tretë Kryetar i Kuvendit Komunal zgjedhet kandidati, i cili merr më shumë se gjysmën e votave të **delegatëve të përgjithshëm dhe që votojnë**, për propozimin në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Neni 9 – Kryetari i Kuvendit Komunal

Pika 6: **Kuvendi Komunal** për ushtrimin e këtyre kompetencave **ka shërbimin e vet, me resurse njerëzore dhe materiale, i cili i përgjigjet Kryetarit të Kuvendit Komunal.**

Neni 10 – Procedura e shkarkimit të **Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit** të Kuvendit Komunal

Propozim: Ky nen duhet të përshtij edhe procedurat për shkarkimin e Zëvendëskryetarit të Kuvendit Komunal.

Neni 11

Propozim: neni 47.3 ndryshohet si vijon: Kërkesa e tillë mund të miratohet apo refuzohet me votën e shumicës së numrit të **pranishëm të delegatëve** të Kuvendit Komunal.

Neni 12

Propozim: Neni 48.1 i Ligjit për Vetëqeverisje lokale duhet të mbetet. Vota e dyfishtë e Kryetarit të Kuvendit Komunal duhet të ekzistojë për rastet kur është i domosdoshëm zhbllokimi i votimit.

Neni 17

Propozim: Pikës 56.3 duhet t'i shtohet edhe një nënpikë si vijon:

56.3 Mandati i kryetarit të komunës përfundon:

- i) nëse kryetari i komunës nuk procedon projektbuxhetin në Kuvendin Komunal sipas ligjeve në fuqi.**

Sa i përket drejtorëve komunal, Kolegjiumi propozon këtë sistem të emërimit:

- **Kryetari i Komunës, pa procedura të konkursit) propozon kandidatët për drejtorë të drejtorive komunale në Kuvendin Komunal. Kuvendi Komunal ka të drejtën të miratoj listën e kandidatëve të propozuar plotësisht apo pjesërisht. Kryetari i Komunës është i obliguar të propozon kandidatë të ri për ato drejtori të cilat nuk janë miratuar fillimisht nga Kuvendi Komunal.**
- **Shkarkimi i drejtorëve të drejtorive komunale bëhet nga Kuvendi Komunal: i) me propozim të Kryetarit të Komunës, apo ii) me inicim të Kuvendit Komunal.**

Neni 18

Propozim për pikën 70.2: propozim-rregulloret në Kuvend Komunal i paraqet Kryetari i Komunës, ndërsa të njëjtat i elaboron/arsyeton drejtori i drejtorisë përkatëse. Kjo përndryshe është edhe praktika e deritanishme e shumicës së Kuvendeve Komunale, prandaj është mirë që kjo të institucionalizohet më ligj. Përndryshe, raportet në Kuvend komunal i paraqet Kryetari i Komunës.

Përveç këtyre propozimeve të bazuara në projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale të përpiluar nga MAPL, Kolegjiumi ngrit edhe çështjet në vijim:

- **Kryetari i Kuvendit Komunal duhet të ketë të përkrahura kompetencat ashtu sikur edhe Kryetari i Komunës.**
- **Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Kuvendit Komunal duhet të jetë me pagë të rregullt dhe me orar të plotë punë, që nënkupton se ai/ajo duhet të ketë zyre dhe shërbim të plotë nën përgjegjësi të tij.**

KONKLuzionet

- **AKK të dërgojë një shkresë tek të gjithë Kryesuesit e Kuvendeve për të kërkuar angazhimin e tyre në punët e Kolegjiumit**
- **AKK të përcjellë komentet në draft LVL në MAPL**